

SPECIFIKIME TEKNIKE

DYER DHE ZHALUZI PER KABINA TRASFORMACIONI

DYERT E KABINAVE

Shtrirja e furnizimit dhe shërbimeve

Ky material përmban ndertimin, prodhimin, testimin, transportin dhe montimin e dyerve kabinave të transformacionit.

Kabinat vendosen në vende me akses për publikun, si rrjedhim kushtet e shfrytëzimit dhe operimit të saj, dyert, zhaluzite dhe të gjitha pjesët e tjera përberëse duhet të jenë të sigurta për publikun.

Dyert e kabinave dhe zhaluzitë do të jenë në përputhje me Standardet SSH, EN, IEC, dhe permiresimet e tyre ose ekuivalentet e tyre. Ato do të paraqesin siguri dhe qëndrueshmëri edhe në kushtet klimaterike që mbizotërojnë në vend.

Në dyer do të ketë pllakata paralajmëruese.

Dyert do të hapen nga jashtë.

Të gjitha furnizimet duhet të jenë conform specifikimeve teknike të OSHEE.

Standartet

Projektimi, materialet dhe testimi sipas kësaj kontrate duhet të plotësojë standartet SSH, EN, IEC ose ekuivalentet e tyre.

Materialet fiksuese, si bullona, dado, rrothë, vida duhet të jenë sipas standartit përkatës SSH, EN, IEC ose DIN. ekuivalentet e tyre.

Materialet duhet të jenë të reja dhe të cilësisë së pare, të përshatshëm për këtë qëllim, dhe të klasifikimit dhe klases së cilësisë sipas botimeve më të fundit të SSH, EN, IEC ASTM, DIN. ose ekuivalente të tyre

Kontrolle dhe teste të fabrikës

Testet duhet të bëhen në fabrikë ose në një laborator të përshatshëm sipas specifikimeve teknike të detajuara. Rezultatet e të gjitha testeve duhet të regjistrohen në raportin dhe të përmbajë të dhëna specifike.

Dyert

Dyert duhet të jenë të një madhësie të tillë që të lejojnë montimin dhe demontimin e paisjeve teknologjike (Tr. 630KVA, celave TM, panelit TU). Dyert janë prej llamarinë me spesor jo më pak se 2 mm dhe profil çeliku. Të gjitha materialet e përdorura janë të zingëruara, përjashtuar rastin kur specifikohet ndryshe. Ato lidhen elektrikisht me rrjetin e tokëzimit. Drejtimi i hapjes së dyerve duhet të jetë nga jashtë me një kënd hapjeje jo më të vogël se 110°. Ato paisen me dritare ajrimi. Në dyert me dy kanate, kanati I majtë duhet të paiset me shula lart dhe poshtë duke bërë bllokimin e tij.

-jane të testuara për rezistencë ndaj harkut

-standarti i furnizimit është me brave me tre rrugë bllokimi.

-dyert pervec braves me tre rruge bllokimi(dy vertikale lart e poshte dhe nje horizontale), duhet te kene edhe veshe per mbyllje me dryn vares si edhe mbrojtese te tij te mbyllur nga te gjitha anet perjashtuer anen e poshtme e cila lejon vendosjen e drynit dhe manovrimin te tij me celes.

Mbrojtjesja e drynit ka permasa 100x100x100 mm dhe eshte prej llamarine celiku 2 mm.

-dyert mund te mbyllen nga brenda thjesht duke levizur nje leve (i ashtuquajtur sistem paniku)

-per ventilim dera te paiset me elemente ventilimi si ne vizatimin perkates.

-elementet e ventilimit ndertohen prej materiali celik rezistent ndaj kushteve atmosferike

-projektimi i dyerve dhe elementeve te ventilimit eshte nje zgjidhje standarte e prodhimit dhe e te gjitha testeve qe kryhen (rezistenca ndaj harkut, per percaktimin e klases se mbrojtjes se kabines, etj) dhe ato realizohen me anen e ketij projekti.

Ajrimi I kabines(pervec deres) behet nga dritare(zhaluzite) me grila metalike. Ventilimi llogaritet per transformator 630 KVA.

Ajrimi duhet te jete I tille qe te nxjerre nxehtesine ne ngarkese dhe temperature maksimale te ambientit.

Dyert duhet te kene shkalle mbrojtje IP 33D.

Detaje te sakta jepen ne fleten e projektit qe ben projektuesi.

Dyert duhet te garantojne mbrojtjen e operatoreve si dhe te publikut te gjere sipas klases IAC-AB 20kA per 1 sek.

Shenjat e sigurimit teknik dhe pengesat

Ne dyert e kabines se transformacionit (perfshire dhe ambjentin e transformatorit me vrimat e ventilimit) vendosen tre tabela te sigurimit teknik me shenimet e meposhteme:

1. Tabela tip TST1 me shenjen e rrufese me shenimin, “Mos prek, rrezik vdekje”.
2. Tabela tip TST2 me fushe te ujit qe derdhet ne zjarr me shenimin “Te mos shuhet me uje ose me paisje me shkume!”
3. Tabela tip TST3 me shenimin “Ndalohej hyrja”.

Zhaluzi

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Per zhaluzite vlejne po te njejtat kerkesa si dhe per dyert.

Kasa e zhaluzise eshte me profil “L” 50x40x4 mm.

Zhaluzite do te jenë në përputhje me Standardet SSH, EN,IEC,dhe permiresimet e tyre ose ekuivalentet e tyre. Ato do të paraqesin siguri dhe qendrushmeri edhe në kushtet klimaterike që mbizotërojnë ne vend.

Ato jane te testuara per rezistence ndaj harkut.

Ajrimi I kabines(pervec deres) behet nga dritare(zhaluzite) me grila metalike. Ventilimi llogaritet per transformator 630 KVA .

Ajrimi duhet te jete I tille qe te nxjerre nxehtesine ne ngarkese dhe temperature maksimale te ambientit.

Zhaluzite duhet te kene shkalle mbrojtje IP 33D. Ato lidhen elektrikisht me rrjetin e tokezimit.

Detaje te sakta jepen ne fleten e projektit qe ben projektuesi.



Zhaluzite duhet te garantojne mbrojtjen e operatoreve si dhe te publikut te gjere sipas klases IAC-AB 20kA per 1 sek.

DETAJE ORIENTUESE


Dyer kabine

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Detaj i grilave te ajrimit




Shenim:

Permasat e treguara ne kete material jane per nje tip te caktuar kabine dhe nuk mund te perdoren per te gjitha tipet. Gjate zbatimit, per cdo dere do te aplikohen permasat e sakta qe do te maten ne vend duke respektuar anen kontruktive te dhene ne kete flete si dhe kushtin e ftohjes se trasformatorit me fuqi deri 630 kVA.


Zhaluzite

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Detaj i grilave te ajrimit



Shenim:

Permasat e treguara ne kete material jane per nje tip te caktuar kabine dhe nuk mund te perdoren per te gjitha tipet. Gjate zbatimit, per cdo zhaluzi do te aplikohen permasat e sakta qe do te maten ne vend duke respektuar anen kontruktive te dhene ne kete flete si dhe kushtin e ftohjes se trasformatorit me fuqi deri 630 kVA.